

Udhëzuesi për vizibilitet

Përmes këtij udhëzuesi përcaktohen obligimet dhe rregullat, të cilat grantistët duhet t'i përmbushin në zbatimin dhe raportimin e grantit të financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

NËNTOR'17

Përkrahur nga:



Përmbajtja

HYRJE	3
KËRKESAT E VIZIBILITETIT	4
Aktivitetet e caktuara për komunikim.....	4
Komunikatat për shtyp	4
Konferencat për Shtyp.....	4
Publikimet	5
Webfaqet	5
Banerët	5
Fotografitë.....	5
Prodhimet audio-vizuele.....	5
Ngjarjet publike	6
Fushatat informative	6
IDENTITETI VIZUEL	7
Llogo e Sida-së	7
Klauzola e përkrahjes së projektit.....	7
Klauzola e përgjegjësisë.....	7
Informatat e shkurtëra mbi grantet.....	7

Përkrahur nga:

HYRJE

Ky udhëzues është hartuar për të siguruar që aktivitetet e përkrahura nga kjo skemë që financohet nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe menaxhohet nga KCSF, promovohen në mënyrë të duhur. Rrjedhimisht, udhëzuesi përcakton rregullat, kushtet dhe ofron udhëzime për promovim.

Përfituesit e granteve janë të obliguar që t'u përmbahen kërkesave dhe udhëzimeve të specifikuar në këtë dokument. Për ilustrim të kërkesave të këtij udhëzuesi, referojuni Shtojcës me mostrat e vizibilitetit. Për çfarëdo paqartësie apo informate shtesë rreth rregullave të vizibilitetit, përfituesit e granteve mund të kontaktojnë KCSF-në për të parashtruar pyetje dhe kërkuar sqarime.

KËRKESAT E VIZIBILITETIT

Të gjithë përfituesit e granteve janë përgjegjës për promovimin adekuat të projektit/programit të përkrahur nga skemat e granteve të KCSF-së.

Projektet dhe programet, specifikiisht aktivitetet e ndryshme, kërkojnë qasje specifike për komunikimin e zbatimit, qëllimin apo rezultatin përfundimtar dhe/apo burimin e financimit të projektit/programit. Seksionet në vijim tregojnë komunikimin e mundshëm të llojeve të përgjithshme të aktiviteteve të financuara nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Përfituesit e granteve duhet të përdorin format standarde (letër shkrimit standard në krye të letrës) të shkronjave në fillim të dokumentit, mirëpo duhet të shtojnë edhe klauzolën “Ky projekt financohet nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)” kur komunikojnë për çështje që ndërlidhen me projektin/programin e përkrahur.

Për aktivitete apo veprime që nuk përmenden më poshtë, përfituesit e granteve nga kjo skemë duhet të konsultohen me personin përgjegjës nga KCSF dhe të marrin udhëzime të qarta mbi vizibilitetin.

Komunikimi me KCSF-në për informim dhe/ose konsultim në raport me kërkesat sipas këtij Udhëzuesi duhet të bëhet së paku 5 ditë pune para aktivitetit/ngjarjes.

Përkrahur nga:

Aktivitetet e caktuara për komunikim

Në vijim janë disa nga elementet komunikimit dhe vizibilitetit të cilat duhet të përmbajnë elemente të identitetit të këtij granti:

- Komunikatat për shtyp
- Konferencat për shtyp
- Fletushkat, broshurat dhe buletinet informativ
- Publikimet
- Webfaqet
- Banerat
- Fotografitë
- Prodhimet audio-vizuele
- Ngjarjet publike
- Fushatat informative

Komunikatat për shtyp

Si rregull i përgjithshëm, komunikata për shtyp duhet të hartohet dhe lëshohet në fillim të çdo aktiviteti publik. Dokumenti duhet të përmbajë klauzolën e përkrahjes, por jo dhe logon e Sida-së. Të gjitha komunikatat për shtyp duhet t'i dërgohen në formë elektronike personit përgjegjës nga KCSF, së paku 5 ditë pune para aktivitetit/ngjarjes.

Konferencat për shtyp

Personi përgjegjës nga KCSF duhet të njoftohet paraprakisht së paku 5 ditë pune për konferencat për shtyp të organizuara në kuadër të projektit të mbështetur nga ky grant. Ftesat duhet të përmbajnë klauzolën e përkrahjes së projektit në përputhje me udhëzimet e cekura në këtë dokument, por jo dhe llogon e Sida-së.

Në konferencë për shtyp, llogoja e SIDA-së duhet të ekspozohet nëse janë ekspozuar edhe llogot apo simbolet e tjera. Këshilla tjera rreth mjeteve promovuese mund të kërkohen nga personi përgjegjës nga KCSF, duke respektuar afatin prej së paku 5 ditë pune para aktivitetit.

Fletushkat, broshurat dhe buletinet informative

Në përgjithësi, të gjitha materialet që prodhohen në letër duhet të ofrohen edhe në formë elektronike, në mënyrë që të mund të dërgohen përmes e-mailit dhe të postohen në webfaqe.

Të gjitha fletushkat dhe broshurat duhet të përmbajnë logon e Sida-së dhe klauzolën e përgjegjësisë së këtij granti në pjesën më të përshtatshme për përmbajtjen, që njëkohësisht mundëson që logoja dhe klauzola të jenë lehtë të dallueshme.

Kopjet, përfshirë këtu edhe kopjet elektronike të botimeve, duhet t'i dorëzohen ekipit të KCSF-së.

Përkrahur nga:

Publikimet

Të gjitha publikimet në mënyrë të qartë duhet të shënjojnë logon e Sida-së në ballinë, ndërsa në faqen e parë të brendisë duhet të vendoset klauzola e përgjegjësisë së kësaj skeme ndërsa në faqe të fundit duhet të vendoset klauzola për përkrahje.

Webfaqet

Të gjitha aktivitetet e përkrahura nga kjo skemë duhet të jenë publike në webfaqet e përfituesve të granteve, bazuar në informatat e shkurtëra mbi përfituesit e granteve. Përmbajtja e lajmërimit duhet të pajtohet paraprakisht me personin përgjegjës nga KCSF. Komunikimi me KCSF rreth përmbajtjes duhet të zhvillohet së paku 5 ditë pune para datës së planifikuar për publikim në webfaqe.

Nëse përmes grantit parashihet dizajnimi i plotë i webfaqes ose ndonjë nën-seksioni të webfaqes, përfituesi i grantit duhet të sigurohet që llogon e Sida-së dhe klauzola e përkrahjes të jetë e përfshirë në webfaqe ose nën-seksionin përkatës.

Banerat

Të gjitha banerat e grantistëve të përkrahur nga kjo skemë duhet të përmbajnë logon e Sida-së dhe klauzolën e përkrahjes.

Fotografitë

Fotografitë që tregojnë progresin e të gjitha aktiviteteve duhet të bëhen sa herë që është e nevojshme në mënyrë që të dokumentojnë progresin e projekteve/programeve dhe të mund të përdoren në materiale komunikuese.

Përfituesi i grantit duhet të sigurohet që kopjet në formatin përfundimtar për distribuim dhe në formatin profesional t'i dërgohen personit përgjegjës nga KCSF.

Sida dhe KCSF do të kenë të drejtë t'i përdorin apo riprodhojnë fotografitë e dorëzuara në arkiv pa pasur nevojë të paguajnë ndonjë tarifë.

Prodhimet audio-vizuele

Prodhimet duhet të përmendin përkrahjen e Sida-së dhe të përmbajnë logon e Sida-së, klauzolën e përgjegjësisë dhe klauzolën e përkrahjes së projektit, në fillim dhe/apo në fund.

Përfituesi i grantit duhet të sigurohet që kopjet në formatin përfundimtar të distribuimit dhe në formatin profesional t'i dërgohen personit përgjegjës nga KCSF.

Përkrahur nga:

Ngjarjet publike

Klauzola e përkrahjes duhet të figurojë në të gjitha materialet e ngjarjeve. Varësisht nga rrethanat, duhet të shfrytëzohet rasti për ekspozimin e banerave në sallat e takimeve.

Ngjarjet dhe vizitat duhet të lajmërohen nëpërmjet komunikatave për shtyp, duhet të sigurohen raportimi në media, fotot profesionale dhe materialet audio-vizuale që duhet të ndahen me personin përgjegjës nga KCSF.

KCSF duhet të informohet paraprakisht së paku 5 ditë pune për përgatitjet dhe realizimin e ngjarjeve.

Fushatat informative

Projektet/programet që përkrahin organizimin e pjesëve të ndryshme të fushatave informative apo realizimin e plotë të fushatave, duhet të bëhen në bashkëpunim të plotë me KCSF-në dhe duhet t'i ndjekin udhëzimet specifike të vizibilitetit të cilat pranohen nga personi përgjegjës nga KC

Përkrahur nga:

IDENTITETI VIZUEL

Llogo Sida

Llogoja e Sida-së dhe ajo e KCSF-së mund të shkarkohen në webfaqen e KCSF-së. Dimensionet e këtyre logove duhet të jenë në propocion me dimensionet e logove të tjera, nëse ka të tilla.

Klauzola e përkrahjes

“Ky projekt është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”

Klauzola e përgjegjësisë

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e Agjensionit Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e <emri i organizatës që ka fituar grantin> dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Sida-së, dhe KCSF-së.”

Informatat e shkurtëra mbi grantet

Shkarko formularin për Informatat e shkurtëra mbi grantet: www.kcsfoundation.org

Përkrahur nga: